



Planuar / Dorezuar Primijsno/Prodato Received/Delivered	23 - 08 2023	3	viti god year
Organ/Njësia Organ/Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojça Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHCK	5779/2023		1/5



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.946/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtar, me Kaltrina Avdullahi-Prenaj-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.946/2023 të datës 11.07.2023 të parashtruar nga ankuesi [redacted], me adresë rruga [redacted] nga Peja, kundër Vendimit me numër protokolli Nr.01/900 të datës 21.06.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në çështjen juridike "kontestim konkursi" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 22.08.2023, mori këtë.

V E N D I M

PËRFUNDON procedimi administrativ i filluar sipas ankesës me numër A.nr.946/2023 e datës 11.07.2023 të parashtruar nga ankuesi [redacted]

Arsyetim

Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës më datë 15.02.2023 ka shpall konkursin e jashtëm me numër Nr.01/2023 për pozitën "Udhëheqës i Zyrës për Buxhet dhe Financa" në Gjykatën Themelore të Pejës në të cilin konkurs kanë aplikuar trembëdhjetë (13) kandidatë në mesin e tyre edhe ankuesi, ku sipas Raportit të datës 01.03.2023 Komisioni Përzgjedhës ka përgatitur listën e ngushtë, nga rrjedhë se sipas këtij raporti nëntë (9) kandidatë (në mesin e tyre edhe ankuesi) kanë plotësuar kushtet e konkursit ndërsa katër (4) kandidat nuk kanë plotësuar kushtet e konkursit.

Në bazë të provave të lëndës, ankuesi është përfshirë në fazat e procedurës konkretisht listën e ngushtë, testin me shkrim dhe intervistën me gojë. Pas përfundimit të procedurës së rekrutimit për pozitën e cekur më lartë sipas formularit Form.MAP-SHCK-10 të renditjes përfundimtare të kandidatëve ankuesi është renditur i dyti me pikë me gjithsejtë 403, ndërsa sipas Njoftimit me numër Nr.03/699 për kandidatin e suksesshëm të datës 12.05.2023, ankuesi nuk rezulton të jetë kandidat i suksesshëm.

Ankuesi kundër njoftimit me numër Nr.03/699 për përzgjedhjen përfundimtare të datës 12.05.2023, më datë 07.06.2023 ka parashtruar ankesë Komisionin për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Ndërsa Komisioni për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës më datë 21.06.2023 ka nxjerr vendim me numër KA.nr.18/2023 përmes të cilit ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankuesit duke e lënë në fuqi njoftimin për përzgjedhjen përfundimtare me numër Nr.03/699 të datës 12.05.2023.

Ankuesi kundër Vendimit me numër Nr.03/699 të datës 12.05.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, më datë më datë 11.07.2023 përmes e-mailit zyrtar ankesa.kpmschck@rks-gov.net ka parashtruar ankesë e cila është protokolluar me numër 5117/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 18.07.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Ndërsa Këshilli me datë 26.07.2023, ka pranuar përgjigjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka Administruar këto Prova: Ankesën me numër protokollit 5117/2023 të datës 11.07.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër KA.nr.18/2023 të datës 21.06.2023; Ankesën e datës 07.06.2023 të parashtruar nga ankuesi në Komisionin për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sekretariatit e KGJK-së; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 18.07.2023; Përgjigje në ankesë me numër Nr.03/1069 e datës 26.07.2023; Fletëkthimi i datës 26.06.2023; Raporti me numër Form.MAP-SHCK-08a i datës 06.05.2023 i testit me shkrim; Raporti me numër Form.MAP-SHCK-08a i datës 04.05.2023 i testit me shkrim; Udhëzuesin për testin me shkrim të datës 04.05.2023; Kërkesa për punësim me numër nr.1398/23 e datës 01.03.2023; Jetëshkrimi i kandidatit B.K; Kopje e letërnjoftimit për B.K; Certifikatë mbi dënimet penale me numër Nr.ser.0935F725704141D e datës 28.02.2023; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për periudhën kohore 01.Janar 2021 deri më 31. Dhjetor 2021; Diplomë me numër Nr.0176 e datës 19.12.2013; Mirënjohje Qershor 2018; Certifikatë Shkurt 2015; Certifikatë e datës 12.11.2002; Certifikatë me numër Nr.218/2016 e datës 16.12.2016; Certifikatë e datës 23.06.2005; Certifikatë e datave 18,19,25 dhe 26 shkurt 2021; Certifikatë e datës 25.05.2013; Certifikatë korrik 2016; Certifikatë 18.03.2004; Njoftimin për përzgjedhjen përfundimtare me numër Nr.03/699 e datës 12.05.2023; Certifikatë e datës 27.12.2004; Certifikatë e datës 20.02.2004; Certifikatë e datës 30.12.2003; Certifikatë e datës 05.03.1995; Certifikatë e datës 28.01.2004; Certifikatë e datës 29.01.2004; Certifikatë 02.01.2004;

Certifikatë e datës 26.05.2009; Certifikatë 24.12.2003; Raport i datës 24.05.2012; Certifikatë e datës 18.08.2004; Certifikatë e datave 22,23 mars 2005; Certifikatë e datave 15,16 dhjetorë 2003; Diplomë për periudhën kohore 22.05.2001-24.11.2001; Shkresë e datës 19.08.2015; Shkresë e datës 15.01.2016; Shkresë; Shkresë e datës 24.07.2008; Shkresë e datës 03.01.2007; Shkresë e datës 21.03.2007; Shkresë e datës 25.06.2003; Shkresë e datës 10.04.2008; Regjistri i aplikacioneve të pranuara i datës 15.02.2023; Përcaktimi i kritereve për përfshirjen në listën e ngushtë me numër Form.MAP-SHCK-05; Raporti final i rekomandimit nga komisioni rekrutues me numër Form.MAP-SHCK-11 i datës 10.05.2023; Renditja përfundimtare e kandidatëve me numër Form.MAP-SHCK-10; Përmbledhja e vlerësimeve individuale me numër Form.MAP-SHCK-09; Deklaratat e datës 06.04.2023; Vendimi me numër nr.03/449 i datës 24.03.2023; Propozimi për emërimin e KPSHC-së i datës 23.03.2023; Vendim me numër KGJK.nr.28/2023 i datës 09.02.2023; Konkursi me numër Nr.03/249 i datës 15.02.2023; Formularët e vlerësimeve të anëtarëve të komisionit për A.M; Udhëzues për testin me shkrim e datës 04.05.2023 me korrespondencën e bashkangjitur; Kërkesa për punësim e A.M e datës 27.02.2023; Kopja e letërnjoftimit për A.M; Certifikata mbi dënimet penale për A.M e datës 21.02.2023; Diplome e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" me numër 1682 e datës 13.07.2018; Diplome e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" me numër 514 e datës 29.04.2014; Certifikatë për përfundimin e kursit e lëshuar nga Corporate Social Responsibility e datës 26.12.2019; Certifikatë e lëshuar nga ShKÇAK; Rekomandim për punësim e lëshuar nga Universiteti i vizionit Evropian i datës 28.08.2009; Vërtetim punësimi e lëshuar nga International Menagment Group e datës 10.12.2020; Kontratë e shërbimeve e lëshuar nga International Menagment Group e datës 28.06.2017; Amendament i Kontratës së shërbimeve e lëshuar nga International Menagment Group e datës 26.09.2017; Amendament i Kontratës së shërbimeve e lëshuar nga International Menagment Group e datës 21.06.2018; Amendament i Kontratës së shërbimeve e lëshuar nga International Menagment Group e datës 17.12.2018; Amendament i Kontratës së shërbimeve e lëshuar nga International Menagment Group e datës 26.12.2019; Amendament i Kontratës së shërbimeve e lëshuar nga International Menagment Group e datës 01.07.2020; Amendament i Kontratës së shërbimeve e lëshuar nga International Menagment Group e datës 22.12.2020; Amendament i Kontratës së shërbimeve e lëshuar nga International Menagment Group e datës 14.06.2021; Kontratë e shërbimeve e lëshuar nga International Menagment Group e datës 31.12.2021; Amendament i Kontratës së shërbimeve e lëshuar nga International Menagment Group e datës 31.03.2022; Kontratë pune e lëshuar nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës me numër 03/1790 e datës 22.09.2022; Letër rekomandimi e lëshuar nga Kryetari i gjykatës Themelore të Pejës; Letër rekomandimi i lëshuar nga Drejtori i Departamentit të TIK në SKGJK i datës 24.02.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se objekti për të cilin për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e ankuesit është bërë i pamundur, *sepse:*

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër KA.nr.18/2023 të datës 21.06.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Sekretariatën e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, pretendon se vlerësimi i pikëve përfundimtare është bërë në mënyrë jo reale, pas

përfundimit të konkursit nuk ka pasur asnjë komunikim zyrtar për rezultatet e konkursit si dhe kandidati i suksesshëm nuk e ka përvojën e nevojshme dhe të përshtatshme për të kryer detyrat dhe përgjegjësitë lidhur me pozitën *"Udhëheqës i Zyrës për Buxhet dhe Financa"*.

Nga administrimi shkresave të parashtruara nga kandidatët për pranim në shërbimin civil, ka gjetur se për të njëjtën procedurë të rekrutimit dhe për pozitën e njëjtë *"Udhëheqës i Zyrës për Buxhet dhe Financa"* të zhvilluar nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës është evidentuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 05.07.2023 ka pranuar ankesë me numër të protokollit 5022/2023 nga një kandidate në procedurë respektivisht kandidatja me iniciale A.K, ndërsa Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me qëllim të shqyrtimit të ankesës së saj me datë 15.08.2023 ka nxjerr vendim me numër A.nr.913/2023, përmes të cilit e ka aprovuar ankesën e ankueses A.K dhe anuluar njoftimin me numër Nr.03/2023 për përzgjedhjen përfundimtare të datës 12.05.2023, listën e ngushtë të kandidatëve duke përfshirë rezultatet e testit me shkrim dhe intervistës me gojë si dhe raportin final të rekomandimit nga Komisioni i Përzgjedhës i datës 10.05.2023, ndërsa lëndën e ka kthyer në *"Ri-shqyrtim duke e obliguar Komisionin Përzgjedhës në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, që të ri-zhvilloj procedurën e rekrutimit për pozitën "Udhëheqës i Zyrës për Buxhet dhe Financa" në Gjykatën Themelore të Pejës, nga faza e përgatitjes së listës së ngushtë.*

Andaj në rrethanat e rastit konkret lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit sikurse edhe me objektin e shqyrtimit të ankesës së tij, gjegjësisht konkursin e zhvilluar si dhe njoftimin me numër Nr.03/2023 për përzgjedhjen përfundimtare të datës 12.05.2023 për pozitën e punës *"Udhëheqës i Zyrës për Buxhet dhe Financa"*, Kolegji i Këshillit konstaton se është vendosur sipas Vendimit me numër A.nr.913/2023 të datës 15.08.2023, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës gjegjësisht aktet e kontestuara nga pala ankuese i ka anuluar, ndërsa Komisionin Përzgjedhës në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës e ka detyruar ta zhvillojë përsëri procedurën e rekrutimit sipas konkursit me numër 01/2023 për pozitën *"Udhëheqës i Zyrës për Buxhet dhe Financa"* në Gjykatën Themelore të Pejës - nga faza e përgatitjes së listës së ngushtë deri në fazën e përfundimit për arsyeje se procedura e rekrutimit është zhvilluar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, ku për rrjedhojë kjo vendimmarrje ka efekte juridike edhe ndaj ankuesit pasi që ka qenë kandidat në procedurë të rekrutimit.

Prandaj nga se u tha si më lartë, pas rrethanave të krijuara juridike e në kuptim të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *"Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë"*, Kolegji i Këshillit, konstaton se meqenëse sipas Vendimit me numër A.nr.913/2023 të datës 15.08.2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës janë anuluar të gjitha veprimet e kësaj procedure deri në shpalljen e konkursit, konsiderohet që ankesa e ankuesit nuk ka objekt shqyrtimi dhe mbi këtë bazë objekti i ankesës është bërë i pamundur apo i kotë.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nën 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.946/2023

Kaltrina Aydullahi-Prenaj

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm në Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.